

VENDIM
Nr.712, datë 23.6.2009

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 24.3.2009, PËR ÇËSHTJEN NR.2141/03 “VRIONI DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË”, DHE PËR PAGESËN E TATIMIT MBI TË ARDHURAT NDAJ PERSONAVE, NË FAVOR TË TË CILËVE JANË EKZEKUTUAR VENDIMET E KËSAJ GJYKATE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të konventës europiane “Për të drejtat e njeriut”, ratifikuar me ligjin nr.8173, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e konventës europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore””, dhe të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9963, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 24.3.2009, për çështjen nr.2141/03 “Vrioni dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, në vlerën 450 000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) euro. Tatimi mbi të ardhurat, në vlerën 10 për qind të kësaj shume, paguhet nga shteti.

2. Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Ministria e Financave dhe afati, brenda të cilit duhet kryer ky ekzekutim, është data 24 qershor 2009.

3. Shuma 450 000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) euro, bashkë me pagesën e tatimit mbi të ardhurat, në vlerën 10 për qind, të depozitohet në njërin nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesve “Vrioni dhe të tjerë”. Kjo shumë të konvertohet në lekë, sipas kursit të këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën e çeljes së kësaj llogarie.

4. Detyrimi financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

5. Ministria e Financave të kryejë pagesën e tatimit mbi të ardhurat, në masën 10 për qind të shumës së dëmshpërblimit, për vendimet e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, të ekzekutuara deri më tani, si më poshtë vijon:

a) Qufaj kundër Shqipërisë	6 883 440 lekë;
b) Beshiri kundër Shqipërisë	1 581 300 lekë;
c) Bajrami kundër Shqipërisë	307 100 lekë;
ç) Gjonboçari kundër Shqipërisë	603 680 lekë;
d) Rramadhi kundër Shqipërisë	827 518 lekë;
dh) Driza kundër Shqipërisë	6 930 000 lekë;
e) Xheraj kundër Shqipërisë	26 560 lekë;
ë) Marini kundër Shqipërisë	4 219 749 lekë;
f) Dybeku kundër Shqipërisë	62 250 lekë.

6. Pagesa e tatimit mbi të ardhurat, në favor të personave të përmendur në pikën 5 të këtij vendimi, të depozitohet në bankën e nivelit të dytë, ku është depozituar shuma përkatëse e dëmshpërblimit, dhe të konvertohet në lekë, sipas kursit të këmbimit të bankës ku është depozituar shuma, në datën kur do të çelet llogaria.

7. Detyrimi financiar, i parashikuar në pikën 5 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

8. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha